



VENDIM

Nr.187, Datë 23.11.2016

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “LUÇENTE KONÇESIONARE”
SH.P.K., PËR LICENCIM NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2 gërma ”d” të ligjit Nr. 43/2015 ”Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, 21 të ”Rregullores për Procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 109, datë 29.06.2016 , neni 4, pika 1, gërma ”g”; neni 5, pika 2; neni 10, pika 3 të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 108, datë 09.09.2008 dhe nenit 19 pika 1 gërma ”a”e “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE”, miratuar me Vendimin nr. 96 datë 17.06.2016 të Bordit të ERE-s, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 23.11.2016, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “LUÇENTE KONÇESIONARE” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut për liçensimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie;

Konstatoi se :

Nga aplikimi i shoqërisë “LUÇENTE KONÇESIONARE” sh.p.k, rezulton mungesa e dokumentacionit si më poshtë:

- Neni 9, pika 3, gërma ”c”, (dokumenta që vërtetojnë aftësinë dhe/ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimin dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera, etj.)
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, gërma ”a”)(sasia e energjisë elektrike e parashikuar për t’u tregtuar); gërma ”b”(kapitali financiar i parashikuar për ushtrimin e këtij aktiviteti) dhe gërma ”c”(Lista e kontratave të mëparshme, nëse ka patur),

- Në korrespondencë zyrtare me ERE, Shoqërisë "LUÇENTE KONÇESIONARE" sh.p.k., i është bërë kërkesë e përsëritur për plotësimin e dokumentacionit të munguar.
- Shoqëria "LUÇENTE KONÇESIONARE" sh.p.k., nuk ka kthyer përgjigje e as ka plotësuar dokumentacionin e nevojshëm për fillimin e procedurave për licencimin në aktivitetin e tregimit të kësaj shoqërie.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të mos fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së Shoqërisë "LUÇENTE KONÇESIONARE" sh.p.k., për t'u licensuar në aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet brenda 30 ditëve në Gjykatën Administrative.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI